



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Inovacije/ Ministry of Education, Science and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 018/048
Datë: 13.05.2024

Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 pika 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 2/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për nxënës në drejtimet deficitare dhe për vajza në drejtimet teknike në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP)

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin e ri shkollor 2024-2025 ndan bursa për nxënësit e IAAP-ve për klasën e 10-të.
2. Vlera e bursës për nxënës është 50 (pesëdhjetë) euro në muaj (përveç muajt korrik dhe gusht), përkatësisht 500 (pesëqind) euro për një vit shkollor.
3. Numri i bursave është 100, në drejtimet deficitare 65 dhe për vajza në drejtimet teknike 35.
4. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve ndërsa, për drejtimet teknike vetëm vajzat.
5. Bursat ndahen për tri vite të shkollimit në AAP siç është përcaktuar me UA.
6. Bursa për drejtimet deficitare:
 - Zhvillues i aplikacioneve softuerike
 - Instalues elektrik
 - Agrobiznes
 - Automekanik
 - Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
 - Përpunimi i drurit/Zdrukthëtar
 - Hortikulturë

7. Bursat për vajza në drejtimet teknike:
- Metalpunues
 - Instalues elektrik
 - Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujës-jellësit
 - Automekanik
 - Teknologjia e riciklimit
 - Teknik i dizajnit grafik

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), duke pas parasysh nevojat e tregut të punës, si dhe në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe stimulimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe vajzave në drejtimet teknike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA-ve);
4. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP);
5. DAAP;
6. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
7. Arkivit të MASHTI

